



Datë: 23.03.2026
Numër Protokoli: 1480/2026

A.nr.112/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.112/2026, të datës 30.01.2026, të parashtruar nga ankuesi D.R, nga Komuna e Zveçanit, kundër organit të punësimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike-administrative “*transferim i përkohshëm*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 23.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e filluar sipas ankesës A.nr.112/2026, të datës 30.01.2026, të parashtruar nga ankuesi D.R.

A r s y e t i m

Ankuesi D.R. (*tutje referuar ankuesi*), më datë 26.01.2026, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 30.01.2026, e regjistruar nën shenjën A.nr.112/2026, kundër Vendimit me Nr.2398/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.02.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 06.03.2026, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së lidhur me këtë çështje juridike-administrative janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës administrative, *sepse*

Nga administrimi i provave materiale Kolegji i Këshillit konstatoi se Ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 11.01.2016, është i punësuar në pozitën “Zyrtar i Rrjeteve”, në Sektorin e Administrimit të Rrjetit Shtetëror, në kuadër të Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit/MPB, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 31.12.2025, ka nxjerr Vendim me Nr.2398/2025, me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita Zyrtar për Rrjet/Agjencia e Shoqërisë së informacionit/MPB-së në pozitën *Asistent Administrativ në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Pejë*.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimin me Nr.2398/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe pretendon se transferimi është bërë fillimisht pa njoftim paraprak me shkrim, akti i kontestuar nuk është arsyetuar mbi gjendjen faktike përkatësisht nuk ka dhënë arsyetim nëse punonjësi i transferuar plotëson kriteret e pozitës ku transferohet, si dhe transferimi duhet bazohet në atë se transferimi i përkohshëm për interes të institucionit është prej gjashtë muaj deri në 12 muaj gjatë dy viteve.

Kolegji i Këshillit në procedurë të shqyrtimit të ankesës A.nr.112/2026 të datës 30.01.2026, ka konstatuar se organi i punësimit ende pa përfunduar procedura ankimore lidhur me kontestimin e Vendimit Nr.2398/2025, të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme për transferimin e përkohshëm, ka ndërprerë marrëdhënien e punës së ankuesit mbi bazën e Vendimit me Nr. 271/2026, të datës 04.02.2026, të Komisionit Disiplinor, e me të cilin vendim ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, akt ky i kontestuar nga ankuesi përmes ankesës A.nr.281/2026, të datës 12.03.2026. Andaj, mbi këto rrethana, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se çështja ankimore e iniciuar sipas ankesës më numër A.nr.281/2026 të datës 12.03.2026, është parakusht për zgjidhjen e ankesës me numër A.nr.112/2026 të datës 30.01.2026, dhe si e tillë përben çështje paraprake, kështu që, në kuptim të nenit 85, paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “*Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përben një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër; organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit*”, Kolegji i Këshillit vendosi që të pezullohet procedura administrative e iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.112/2026, të datës 30.01.2026, deri në vendosje të ankesës me numër A.nr.281/2026 të datës 12.03.2026.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.112/2026, datë 23/03/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit D.R;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.